



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 1053/prot.
3

Tiranë më 13.07.2018

REKOMANDIM

Nr. 23, datë 13.07.2018

PËR KONTROLLUESIN UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS SH.A.

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 167 datë 21.06.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a.", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a."

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a." person juridik me NIPT J61819502V, u iniciua nga Zyra e Komisionerit bazuar në programin e punës së institucionit.

"Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a." mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë "punonjës" për qëllim të punësimit, "familjarë" dhe "vizitorë" për ofrimin e shërbimeve Ujësjiellës-Kanalizime dhe të informacioneve. Në kuptim të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", "Ujësjiellës Kanalizime Durrës sh.a." merr cilësinë e kontrolluesit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në vitin 2011. Gjatë hetimit administrativ të ushtruar, është

konstatuar se kontrolluesi disponon sistem video-survejimi, përhap të dhëna personale ndaj palëve të treta (si Adel Co shpk për printimin e faturave dhe Kreatex për sistemin informatik të faturimit), etj., por këto mjete dhe qëllime të reja përpunimi nuk janë deklaruar pranë Zyrës së Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 21 dhe nenit 22 të Ligjit nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar: *“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji”*.

2. Kontrolluesi disponon rregullore për *“Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Në rregulloren e brendshme të institucionit ka përshkrime pune për specialistët e drejtorisë së teknologjisë dhe informacionit por nuk konstatohen procedura të shkruara në lidhje me funksionimin e sistemeve, qarkullimin e informacionit, ruajtjen e të dhënave (Backup), vazhdimësinë e biznesit përshkrimet e proceseve të punës për sistemin e video-survejimit (CCTV) etj. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit, Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”* dhe Udhëzimit nr. 21/2012 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*.
3. Kontrolluesi ka nënshkruar *“Deklaratë Konfidencialiteti”* me punëmarrësit të cilët kanë akses në mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale.
4. Kontrolluesi disponon sistem video-survejimi (CCTV). Qëllimi i përdorimit të këtij sistemi është garantimi i sigurisë në ambientin e punës. Nëpërmjet këtij sistemi, kontrolluesi mbikëqyr territorin e brendshëm të ndërmarjes dhe ambientet e pritjes dhe komunikimit me klientët. Koha e ruajtjes së të dhënave në sistemin e video-survejimit (CCTV) është 5 ditë. Në hyrje të ambienteve të cilat mbikëqyren nëpërmjet sistemit të video-survejimit janë vendosur tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV).
5. Kontrolluesi nuk ka publikuar politikat e privatësisë në portalin www.ukdurrres.al, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në *“Politikat e Privatësisë”*, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit pika 1 - *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”*.
6. Në akt marrëveshjet me palë të treta si *“Adel Co shpk”* për printimin dhe zarfimin e faturave si dhe kontratën me *“Kreatex shpk”* me objekt shërbimet e përmirësimit dhe

mirëmbajtjes së softwareve, janë parashikuar detyrime për ruajtjen e konfidencialitetit megjithatë, këto kontrata nuk janë sipas parashikimeve të nenit 20 të ligjit.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe Udhëzimit nr.19/2012 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*".

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, është mbajtur procesverbali në prezencë të përfaqësuesit të kontrolluesit i cili e nënshkroi pa vërejtje.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje të neneve 18, 20, 21, 22 dhe 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", Udhëzimit nr. 21/2012 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*" si dhe Udhëzimit Nr. 19/2012 të Komisionerit "*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*". Nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit dhe i gatshëm për riparimin e menjëhershëm të shkeljeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me Akt Rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli.

Për sa më sipër,

Në zbatim të neneve 18, 20, 21, 22, 27, 29, 30, 31 dhe 32/1 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*",

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi "*Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.*", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të përditësojë njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale, në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi "*Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.*", në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të hartojë dhe miratojë procedura të shkruara në lidhje me funksionimin e sistemeve, qarkullimin e informacionit, ruajtjen e të dhënave (Backup), vazhdimësinë e biznesit përshkrimet e proceseve të punës për sistemin e video-survejimit (CCTV) etj., në përputhje me veprimtarinë e tij.
3. Kontrolluesi "*Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.*", në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të hartojë dhe publikojë politikat e privatësisë në portalin zyrtar www.ukdurrës.al.
4. Kontrolluesi "*Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a.*", në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", të gjitha rastet e delegimit të

përpunimit të të dhënave personale, ti formalizojë sipas parashikimeve të ligjit dhe Udhëzimit nr. 19/2012 të Komisionerit, mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".

5. Kontrolluesi "Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a.", të përmbushë detyrimet e parashikuara në këtë Rekomandim brenda afatit 60 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjorbë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.07.2018

